



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURES
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 483 Prot.

Tiranë, më 03.04 2018

VENDIM Nr. 67, datë 20.03.2018

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.4, datë 20.03.2018, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Rijetëzimi i Kalasë së Pecës, si aset për zhvillimin turistik dhe kulturor të Bashkisë së Kukësit"*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), drejtues Prof. Luan Përzhita paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Rijetëzimi i Kalasë së Pecës, si aset për zhvillimin turistik dhe kulturor të Bashkisë së Kukësit"*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), drejtues Prof. Luan Përzhita paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
 - a) Pastrimi nga vegjetacioni i ulët në zonat:
 - Muri rrethues
 - Kisha me ambientet e saj
 - Godina rreth murit rrethues
 - Muret e taracimeve
 - Kulla në formë U-je
 - b) Krijimi i infrastrukturës për rrugët, elektrikun dhe ujësjellësin.
2. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë ajo e nevojshme, për kryerjen e tyre, brenda vitit 2018.

3. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.
4. Të depozitohet pranë ASHA dhe DRKK lista e gjetjeve me qëllim grumbullimin dhe ekspozimin e tyre në Muze.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FLORINI
MINISTRE



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO

